



BULETIN

3- MUJOR/NR.

KORRIK-SHTATOR 2007

PASQYRA E TITUVJE
KRYESORË :

1. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË QYTETARËVE
2. AVOKIM DHE LOBIM NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT
3. NGRITJE KAPACITETESH DHE VEPRIMTARI TRAJNUESE
4. ADRESIMI I PROBLEMEVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT TE INSTITUCIONET SHTETËRORE
5. RRRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT LIDHUR ME TË DREJTAT E NJERIUT
6. ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I ORGANIZATËS
7. RRRITJA E BASHKËPUNIMIT TË KSHH-SË ME OJF-TË LOKALE DHE RAJONALE
8. RRRITJA E AKSESIT TË QYTETARËVE TE KSHH-JA

Përgatiti buletin: *Klesta Alkaj*

Koordinatorë projekt

Redaktimi letrar: *Marie Mato*

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

BULETIN

Tetor - dhjetor 2007

Botimi i këtij buletini të përgatitur në kuadër të transparencës me publikun u realizua me mbështetjen financiare të CORDAID-it "CATHOLIC ORGANISATION FOR RELIEF AND DEVELOPMENT"

Më shumë vëmendje për respektimin e të drejtave të emigrantëve

Komiteti Shqiptar i Helsinkit gjatë muajve shtator-dhjetor 2007 ka zhvilluar disa misione vëzhgimi në pikat kufitare për të monitoruar respektimin e të drejtave të emigrantëve shqiptarë nga policia vendëse dhe ajo e huaj, si dhe për të evidentuar problemet kryesore. U realizuan gjithsej 11 misione vëzhgimi në pikat kufitare të Muriqanit, Shëngjinit, Hanit të Hotit, Bajzës, Kakavijës, Kapshticës, Tushemishtit, Qafë-Thanës, si dhe të portit të Vlorës dhe të Durrësit

Vazhdon në faqen 2

Ofrim ekspertize ligjore për projektligjin "Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it"

Për të dhënë ndihmesën e vet në përmirësimin e kuadrit ligjor për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut, me ftesë të Ministrisë së Shëndetësisë, në muajin nëntor 2007 KSHH-ja ka ofruar ekspertizë ligjore për projektligjin "Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it".

Vazhdon në faqen 3

Publikimi i raportit final të monitorimit të ecurisë së procesit të integritetit evropian të Shqipërisë

Si anëtar i Rrjetit të Shoqërisë së Hapur në Shqipëri (NOSA), KSHH-ja iu bashkua nismës së këtij rrjeti për monitorimin e procesit të përmirësimit të angazhimeve të marra nga Shqipëria në kuadër të procesit të stabilizim- asociimit.

Vazhdon në faqen 9

Për më shumë informacion mund të na kontaktoni në adresën:

1. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË QYTETARËVE

1.1 Misione vëzhgimi

1.1.1 Më shumë vëmendje për respektimin e të drejtave të emigrantëve

Komiteti Shqiptar i Helsinkit gjatë muajve shtator-dhjetor 2007 kreu disa misione vëzhgimi për monitorimin e respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë nga policia vendëse dhe ajo e huaj në pikat kufitare të Muriqanit, Shëngjinit, Hanit të Hotit, Bajzës, Kakavijës, Kapshticës, Tushemishtit, Qafë-Thanës, si dhe të portit të Vlorës dhe të Durrësit¹.

Krahas takimeve me drejtues të lartë të policisë në qark si dhe me stafin e policisë kufitare, u vëzhgua edhe infrastruktura e mjediseve pritëse dhe e mjediseve të tjera në pikat e kalimit të kufirit, si dhe u intervistuan emigrantë shqiptarë të ndaluar për kalim të paligjshëm të kufirit.

Me qëllim përmirësimit të respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë dhe personave të huaj që kalojnë përmes këtyre pikave kufitare, si dhe për të nxitur marrjen e masave konkrete, KShH-ja, bazuar në gjetjet e vëzhgimeve, i adresoi problemet e konstatuara, rekomandimet dhe sugjerimet tek organet përgjegjëse shtetërore.

1.1.2 Komiteti Shqiptar i Helsinkit vëzhgon institucionet e paraburgimit

Përparësi e punës dhe e veprimtarisë së KShH-së në vite ka qenë dhe mbetet respektimi i të drejtave të personave të dënuar me heqje lirie. Në këtë kuadër, gjatë muajve nëntor-dhjetor 2007, ndërmori një raund vëzhgimi në disa institucione paraburgimi dhe burgje, përkatësisht në rrethet: Berat, Vlorë, Krujë, Kukës, Tropojë, Korçë, Rrogozhinë, Peqin, Lezhë si dhe në qendrën spitalore të burgjeve në Tiranë².

Qëllimi kryesor i këtij misioni të vëzhgimeve ishte të ndiqte nga afër si respektohen të drejtat e personave të paraburgosur në përgjithësi, si dhe të drejtat e të miturve dhe grave në veçanti.

Bazuar në gjetjet e vëzhgimeve, me anë të një deklarate për shtyp të datës 15 nëntor 2007, KShH-ja denoncoi gjendjen e rëndë në institucionin e paraburgimit të Vlorës. Shqetësimet e tjera ia paraqiti ministrit të Drejtësisë dhe zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve duke kërkuar marrjen e masave të nevojshme për respektimin e të drejtave të personave të arrestuar dhe të dënuar.

¹ Vëzhgimet janë realizuar në kuadër të projektit “Standardet europiane dhe respektimi i të drejtave të emigrantëve”.

² Vëzhgimet do të vijojnë edhe në muajt në vazhdim në kuadër të projektit “Për një respektim më të mirë të të drejtave të të miturve dhe grave në institucionet penitenciare”.

1.2 Komiteti Shqiptar i Helsinkit anketon qytetarët dhe administratën bashkiake lidhur me njohjen dhe respektimin e të drejtave të minoriteteve

Për të vlerësuar pjesëmarrjen e minoriteteve në organet e qeverisjes vendore, gjatë periudhës shtator-tetor të vitit 2007 KShH-ja realizoi një anketim të publikut dhe një vetëvlerësim të administratës së bashkive: Tiranë, Elbasan, Fier dhe Gjirokastrë. Intervistimet në bashkitë përkatëse i realizuan 45 studentë. Pjesë e këtij anketimi u bënë edhe administratat bashkiake dhe këshillat bashkiakë të bashkive të sipërcituara. Ndërkohë KShH-ja po harton raportet përkatëse të cilat do t'ua dërgojë këshillave bashkiakë të bashkive, organizatave vendore dhe atyre të minoriteteve e komuniteteve.

2. AVOKIM DHE LOBIM NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

2.1 Ofrim ekspertize në fushën e legjislacionit dhe të zbatimit të tij

Ofrim i ekspertizës ligjore në përmirësimin e legjislacionit shqiptar në fushën e emigracionit

Në kuadër të misionit të tij për të dhënë ndihmesën e vet në përmirësimin e kuadrit ligjor në respektim të të drejtave të njeriut, gjatë muajve nëntor-dhjetor 2007, Komiteti Shqiptar i Helsinkit u angazhua në përgatitjen e dy oponentëve ligjore, përkatësisht të projektligjit “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror” dhe atë “Për të huajt”. Ekspertët e KShH-së, të cilët kanë përvojë profesionale shumëvjeçare në këtë fushë, kanë ofruar ekspertizë ligjore konstruktive duke shfrytëzuar legjislacionin shqiptar si dhe standardet ndërkombëtare në fushën e emigracionit. Duke vlerësuar rëndësinë e projektligjeve në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të emigrantëve shqiptarë dhe atyre të huaj, këto mendimet dhe opinione ligjore u janë dërguar të gjitha institucioneve përgjegjëse shtetërore që janë duke punuar për hartimin dhe rishikimin e tyre.

Ofrim ekspertize ligjore për projektligjin “Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it”

Për të dhënë ndihmesën e vet në përmirësimin e kuadrit ligjor për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut, me ftesë të Ministrisë së Shëndetësisë, në muajin nëntor 2007 KShH-ja ka ofruar ekspertizë ligjore për projektligjin “Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it”. Mendimet dhe opinionet ligjore të KShH-së si dhe të aktorëve të tjerë të shoqërisë civile lidhur me këtë projektligj i janë dërguar grupit të punës pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe UNDP-së. Këto mendime janë prezantuar edhe në një tryezë të rrumbullakët që u mbajt për këtë qëllim. KShH-ja vlerëson marrjen e nismës për hartimin e këtij projektligji duke qenë se ligji ekzistues nuk u përgjigjet kërkesave dhe nevojave të realitetit dhe se ndryshimi i tij është pjesë e nismave ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga plani kombëtar i zbatimit të marrëveshjes së stabilizim-asociimit. KShH-ja i rekomandoi Ministrisë së Shëndetësisë rishikimin e projektligjit “Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it” në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

KSHH-ja ofron mendime për projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

Gjatë muajit dhjetor 2007 KShH-ja studioi projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe bëri komentet dhe dha sugjerimet e veta për të shërbyer në garantimin dhe forcimin e shtetit ligjor si edhe në respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të së drejtës së privatësisë në mënyrë të veçantë.

Ndër të tjera, KShH-ja ka sugjeri që ky projektligj të bëhet objekt diskutimi dhe debatesh në një rreth më të gjerë të specialistëve të fushës kushtetuese, proceduralo-penale dhe administrative, duke përfshirë dhe shoqërinë civile me ndihmesën e saj, para miratimit të tij nga komisionet ose seanca plenare e Kuvendit.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ofron mendime për projektvendimin “Për zhvillimin e aktivitetit të punësimit në institucionet e ekzekutimeve penale dhe kriteret e shpërblimit të saj”

Në përgjigje të kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për marrje mendimi për projektvendimin “Për zhvillimin e aktivitetit të punësimit në institucionet e ekzekutimeve penale dhe kriteret e shpërblimit të saj”, KShH-ja paraqiti një sërë sugjerimesh për përmirësimin e këtij projektvendimi³. Gjatë shqyrtimit të projektvendimit u pa nëse ky projekt ishte në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut, me parimet kushtetuese dhe legjislativonin në fuqi si edhe u ofruan sugjerime për të bërë të mundur zbatimin e drejtë të këtij vendimi në praktikë.

KSHH-ja ofron mendime për projektstrategjinë kombëtare të zhvillimit të integruar

Në kuadër të hartimit të strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim, 2007-2013, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka dhënë mendimet dhe sugjerimet e veta në disa fusha të strategjisë, si: sistemin e burgimeve dhe të paraburgimit lidhur me trajnimin e personelit të burgjeve, fuqizimin e qendrës së trajnimit të administratës së burgjeve, kuadrin nënligjor dhe praktikën për realizimin e punësimit në burgje, aplikimin e dënimeve alternative në sistemin penitenciar shqiptar, reformën e drejtësisë penale për të miturit. Gjithashtu, KShH-ja ka dhënë mendime edhe në fushën e të drejtave të minoriteteve dhe policisë në tryezat e rumbullakëta të mbajtura për këtë qëllim dhe ua ka dërguar ato me shkrim autoriteteve kompetente.

2.2 Këshillime ligjore, trajtim ankesash dhe ndërhyrje në institucione shtetërore⁴

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ofron ndihmë ligjore falas në favor të emigrantëve shqiptarë dhe personave të kthyer

³ Gjatë viteve 2006-2007 KShH-ja ka ofruar ekspertizë ndërkombëtare gjatë gjithë procesit nga konceptimi i nismës për hartimin e një akti nënligjor që do të rregullonte punësimin, deri në dhënien e sugjerimeve dhe të komenteve për versionet paraprake të këtij projektvendimi.

⁴ Trajtimi i letrave dhe i ankesave bëhet në kuadër të klinikës ligjore, mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit

Me qëllim ofrimin e ndihmës ligjore për emigrantët shiptarë dhe personat e kthyer, rritjen e aksesit të tyre te shërbimet që ofron KShH-ja, adresimin dhe ndërmjetësimin e çështjeve të tyre pranë institucioneve shtetërore shqiptare dhe atyre ndërkombëtare, në bashkëpunim edhe me grupin monitorues të Helsinkit Grek për përfaqësimin e çështjeve të emigrantëve shiptarë në Greqi para gjykatave greke dhe, në raste të caktuara, para Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, gjatë muajve shtator-dhjetor 2007, në Gazetën Shqiptare, gazetën “Emigranti” si dhe në faqen e internetit të Balkan Web, KShH-ja botoi njoftimin për funksionimin e linjës telefonike në favor të mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të emigrantëve shqip tarë dhe të personave të kthyer. Të drejtën për përfitimin e ndihmës ligjore falas, theksohej në këtë njoftin, e kanë të gjithë emigrantët shiptarë dhe personat e kthyer në rast se të drejtat e tyre shkelen nga autoritetet shtetërore shqiptare ose ato të shteteve ku ata jetojnë.

Qytetarët i drejtohen KShH-së

Në kuadër të Klinikës Ligjore mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit janë dhënë disa lloj shërbimesh. Gjatë kësaj periudhe janë **trajtuar 97 ankesa**, në **47 raste** është bërë verifikimi i tyre në institucione të caktuara kryesisht në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe paraburgime, në 49 raste është dhënë këshillim ligjor personave të cilët kanë bërë një kërkesë të tillë. Në më pak raste është ofruar asistencë në plotësimin e dokumentacioneve në Gjykatë si dhe monitorimi i proceseve gjyqësore. Në **84 raste** lidhur me ankesat u është drejtuar shkresë institucioneve shtetërore duke ushtruar presion përta i përket verifikimit të rasteve dhe rivendosjes në vënd të të drejtave të qytetarëve.

Objekti kryesor gjatë kësaj periudhe janë ankesa ndaj organeve të gjyqësorit dhe prokurorisë si dhe kërkesa për këshillime ligjore dhe përfaqësime në gjykatë për çështje të ndryshme. Një numër i madh ankesash kanë ardhur nga të dënuar të cilët ankohen për shkelje të të drejtave të tyre në burgje dhe vëndet e paraburgimit. Nuk mungojnë rastet e pretendimeve nga ankuesit për ushtrim dhune.

Gjatë kësaj periudhe numrin më të madh të objektit të ankesave e ka zënë neni 6 i Konventës Europiane të të drejtave të njeriut. Gjithashtu në **muajin tetor dhe nëntor 2007** është bërë përfaqësimi në Gjykatën e Apelit Shkodër të një të mituri që i përkiste minoritetit rom. Pretendimet e ngritura nga KShH në proces gjyqësor ishte për shkak të procesit të parregullt, për mungesë të avokatit mbrojtës gjatë procesit të hetimit. ***Për më shumë informacion shih faqen tonë të internetit.***

3. NGRITJE KAPACITETESH DHE VEPRIMTARI TRAJNUESE

3.1 Rritja e profesionalizmit të drejtorëve të burgjeve shqiptare dhe drejtuesve të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve lidhur me drejtimin e institucioneve⁵

Komiteti Shqiptar i Helsinkit vlerëson se rritja e kapaciteteve profesionale të nivelit të lartë drejtues të institucioneve penitenciare luan rol në përmirësimin e respektimit të të drejtave të personave në vendet e paraburgimit dhe në burgje. Për këtë, në datat 11-13 dhjetor 2007, KShH-ja organizoi një sesion pune për disa çështje strategjike lidhur me drejtimin e institucioneve penitenciare shqiptare. Sesioni i punës u përqendrua në “përkthimin” në praktikë të disa rregullave dhe rekomandimeve ndërkombëtare të fushës penitenciare nga personeli i burgjeve në institucionet e tyre penitenciare; në planifikimin dhe kontrollin, si dhe në delegimin e kompetencave dhe zbatimin e Kodit të sjelljes nga personeli në punën e përditshme në institucion⁶.

Pjesëmarrësit paraqitën shqetësimet dhe përparësitë, për të cilat u ofruan edhe sugjerime konkrete për përmirësimin e situatës së tanishme. Në këtë sesion pune morën pjesë zyrtarë të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të gjithë drejtorët e institucioneve të paraburgimit dhe të burgjeve.

3.2 Takim pune për politikat e burimeve njerëzore të sistemit të burgjeve shqiptare⁷

Në datat 15-17 tetor 2007, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) organizoi një takim pune për menaxhimin e burimeve njerëzore në institucionet penitenciare shqiptare. Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte hartimi i politikave dhe i strategjive që do të shërbejnë për zhvillimin e burimeve njerëzore në institucionet penitenciare, si Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) dhe institucionet penitenciare lokale.

Ky aktivitet synonte të prezantonte parimet dhe modelet e politikave të zhvillimit të stafit, të sistemit të karrierës, si dhe përfitimet e politikave/strategjive dhe procedurave të tilla, me qëllim ndërtimin e një institucioni të qëndrueshëm në vazhdimësi lidhur me burimet njerëzore si edhe mirëfunksionimin e përgjithshëm të institucionit.

Në këtë aktivitet morën pjesë: stafi i nivelit të lartë drejtues në DPB, veçanërisht drejtoria e burimeve njerëzore, sektori i trajnimit, drejtoria e çështjeve ligjore dhe shoqërore, drejtoria e policisë si dhe stafi i nivelit të lartë në institucionet penitenciare lokale.

⁵ Ky aktivitet u zbatua në kuadër të programit ‘Drejtimi human i burgjeve’, CARDS 2004, i cili mbështetet financiarisht nga Delegacioni i Komisionit Europian në Tiranë.

⁶ Në këtë sesion ofruan ekspertizën e tyre ekspertët e ndërkombëtarë z. Cees Boeij dhe z. Jacques van Huet, drejtorë rajonalë burgjesh në Agjencinë Holandeze të Institucioneve të Korrektimit.

⁷ Ky aktivitet është pjesë e programit ‘Drejtimi human i burgjeve’ i cili mbështetet financiarisht nga Delegacioni Europian në Tiranë, në kuadër të programeve CARDS 2004

3.3 Mbështetje për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për një menaxhim më të mirë të burimeve njerëzore⁸

Për të ndihmuar sistemin e burgjeve, veçanërisht sektorin e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB) si edhe për të përmirësuar sistemin e përzgjedhjes së personelit e të përshkrimeve aktuale të punës, në datat 21-23 nëntor Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi një sesion pune. Në këtë sesion u trajtua hartimi i disa profileve të punës për disa pozicione pune në institucionet penitenciare, si edhe për disa modele të intervistave gojore dhe të testeve të shkruara për personat që do të rekrutohen në sistemin e burgjeve.

Për realizimin e këtij sesioni, grupi shqiptar i punës u asistua nga ekspertë ndërkombëtarë me përvojë në këtë fushë, si z. Cees Boeij, Drejtor Rajonal i Burgjeve në Holandë, z. Frank Borst, zëvendës drejtor i Qendrës së Trajnimit të Burgjeve dhe z. Jan van den Brand, Drejtor Rajonal i Burgjeve në Holandë.

3.4 Sesion pune për progresin e kryer për planin e veprimit të Qendrës së Trajnimit të Burgjeve⁹

Në datat 21-23 nëntor 2007, Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi një sesion pune për progresin e kryer për planin e veprimit për 2008-2010-ën të Qendrës së Trajnimit të Burgjeve (QTB). Duke konsideruar gjendjen në të cilin ndodhet QTB-ja dhe nevojën e transformimit të saj në një qendër bashkëkohore, sesioni i punës kishte si qëllim dhënien e ndihmesës dhe mbështetjen e grupit shqiptar të punës për përmirësimin dhe rregullimin e planit të veprimit të QTB-së¹⁰. Sesioni i punës ishte në vazhdimësi të misionit të vlerësimit që u krye në shtator, lidhur me transformimin e QTB-së. Grupi shqiptar i punës përbëhej prej specialistëve të sektorit të trajnimit, drejtorëve të institucioneve penitenciare me përvojë në trajnime dhe përfaqësuesve të nivelit të mesëm dhe të lartë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB).

3.5 KSHH-ja trajnon gazetarët¹¹

Duke vlerësuar rolin e medias në parandalimin e formave të ndryshme të diskriminimit, si dhe rolin e profesionalizmit të saj në trajtimin e minoriteteve, veçanërisht të minoritetit rom dhe atij egjiptian, në datën 17 dhjetor 2007, Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi një trajnim gjysmëditor me gazetarë të medias së shkruar dhe asaj elektronike. Gazetarët që morën pjesë në trajnim, patën mundësi të thellojnë njohuritë e tyre në lidhje me

⁸ Ky aktivitet u zbatua në kuadër të programit 'Drejtimi human i burgjeve', CARDS 2004, i cili mbështetet financiarisht nga Delegacioni i Komisionit European në Tiranë.

⁹ Ky aktivitet zbatohet në kuadër të programit 'Drejtimi human i burgjeve', CARDS 2004, i cili mbështetet financiarisht nga Delegacioni i Komisionit European në Tiranë.

¹⁰ Në këtë sesion ofruan ekspertizën e tyre edhe ekspertët ndërkombëtarë: znj. Vesna Babic, drejtoreshë e Departamentit të Trajnimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve në Kroaci; z. Frank Borst, zëvendës drejtor i Qendrës së Trajnimit të Burgjeve në Holandë dhe z. Jan van den Brand, drejtor i përgjithshëm i Burgjeve në Holandë.

¹¹ Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit "Rritja e rolit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore në promovimin dhe respektimin më të mirë të të drejtave të minoriteteve"

konceptet e diskriminimit të hapur dhe të fshehtë në media, të intolerancës, me trajtimin e grupeve të veçanta të shoqërisë, standardet ndërkombëtare si dhe me etikën profesionale gjatë ushtrimit të profesionit.

Pjesë e grupit të trajnuar ishin edhe përfaqësues të organizatave rome dhe egjiptiane duke u dhënë kështu mundësi përfaqësuese të medias dhe të komuniteteve të vendosnin lidhje dhe të forconin bashkëpunimin.

4. ADRESIMI I PROBLEMEVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT TE INSTITUCIONET SHETËRORE

4.1 Takime me autoritetet shtetërore

Gjatë muajve shtator-dhjetor 2007, KShH-ja realizoi një sërë takimesh me përfaqësues të ndryshëm të autoriteteve qendrore shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve dhe të personave të huaj si edhe me përfaqësues të organizatave vendëse dhe ndërkombëtare që punojnë në këtë fushë. Qëllimi i këtyre takimeve ishte shkëmbimi i informacionit lidhur me nismat dhe ndihmesën e secilit aktor në fushën e respektimit të të drejtave të emigrantëve dhe personave të kthyer, si dhe forcimi i bashkëpunimit dhe gjetja e formave të ndryshme të koordinimit për realizimin e aktiviteteve që janë në fokusin e të dyja palëve për një respektim më të mirë të të drejtave të emigrantëve.

4.2 KSHH-ja u adresohet autoriteteve shtetërore lidhur me të drejtat e minoriteteve

Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2007 Komiteti Shqiptar i Helsinkit u ka dërguar letra autoriteteve për çështje që prekin minoritetet. Në këtë kuadër, KShH-ja ka komunikuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Komitetin Shtetëror të Minoriteteve, Zyrën për Monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Punëve të Jashtme etj. Ka komunikua rr kryesisht për ngritjen e problemeve që prekin minoritetet, si për arsimin, shërbimin ligjor falas për grupet e diskriminuara, trajtimin e tyre nga forcat e policisë etj. Gjithashtu, KShH-ja u ka kërkuar institucioneve shtetërore rritjen e bashkëpunimit për të pasur një rezultat më të mirë të punës në mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve.

5. RITJA E NDËRGJEGJËSMIT LIDHUR ME TË DREJTAT E NJERIUT

5.1 Reagime publike të KSHH-së

Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2007, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka qenë i ndjeshëm ndaj zhvillimeve të ndodhura në shoqërinë shqiptare dhe, nëpërmjet deklaratave për shtyp, ka reaguar publikisht për: gjendjen në vendet e paraburgimit në Vlorë, projektligjin për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, vrasjen e shtetasit shqiptar nga patrulla greke etj. Për më shumë, shih në adresën: <http://ahc.org.al/kshh/DEKLARATA.html>

5.2 Tryeza të rumbullakëta

Për të dhënë ndihmesën e vet në respektimin më të mirë të të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të minoriteteve në veçanti, në datën 7 dhjetor 2007, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi tryezën e rumbullakët “Forcimi i bashkëpunimit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore për një respektim më të mirë të të drejtave të minoritetit rom dhe komunitetit egjiptian në Shqipëri”.

Në tryezë u prezantua problematika e minoritetit rom dhe komunitetit egjiptian, parë në këndvështrimin e zbatimit të rekomandimeve të ECRI-t, veprimet e shoqërisë civile dhe nismat e saj në fushën e minoriteteve. Gjithashtu, tryeza krijoi mundësi për identifikimin e veprimeve dhe të aksioneve të përbashkëta të shoqërisë civile dhe të institucioneve shtetërore për një lobim më të mirë në mbrojtje të të drejtave të minoritetit rom dhe komunitetit egjiptian.

Në tryezë ishin të pranishëm përfaqësues të organizatave të minoritetit rom dhe komunitetit egjiptian, të institucioneve shtetërore, të organizatave vendëse dhe ndërkombëtare etj.

5.3 Raporte studimore dhe kërkimore

5.3.1 Përmbledhje e rekomandimeve të organizatave vendëse dhe ndërkombëtare lidhur me të drejtat e minoriteteve në përgjithësi, fokusuar në mënyrë të veçantë në minoritetin rom dhe në komunitetin egjiptian

Gjatë periudhës shtator-nëntor 2007 Komiteti Shqiptar i Helsinkit përgatiti një raport kërkimor, objekti i të cilit ishte zbatimi nga Shqipëria i rekomandimeve të raportit III të Komisionit European kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), si edhe disa çështje të veçanta që lidhen me qëndrimin ndaj komunitetit rom dhe atij egjiptian, me pjesëmarrjen e tyre në jetën politike, përfaqësimin në institucionet publike, zbatimin e strategjisë së romëve, trafikimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë dhe diskriminimin bazuar në identitetin egjiptian.

Ky raport synon të japë një paraqitje të përgjithshme lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Komisionit European kundër Racizmit dhe Intolerancës për periudhën janar 2005-tetor 2007 si edhe të masave që duhet të ishin marrë në kuadër të zbatimit të planit kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së stabilizim-asociimit. Raporti u paraqit në tryezën e rumbullakët të mbajtur më 7 dhjetor 2007, organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

5.3.2 Publikimi i raportit final të monitorimit të ecurisë së procesit të integritetit evropian të Shqipërisë

Si anëtar i Rrjetit të Shoqërisë së Hapur në Shqipëri (NOSA), Komiteti Shqiptar i Helsinkit iu bashkua nismës së këtij rrjeti për monitorimin e procesit të përmbushjes së angazhimeve të marra nga Shqipëria në kuadër të procesit të stabilizim- asociimit. Raporti i monitorimit mbulon periudhën që erdhi 2006-shtator 2007 dhe bazohet mbi angazhimet e marra nga Shqipëria në përputhje me marrëveshjen e stabilizim-asociimit, dokumentin e partneritetit evropian, raportet vjetore të progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë si edhe me planin kombëtar për zbatimin e MSA-së.

Raporti bën analizë të progresit të arritur dhe të masave të marra për përmbushjen e angazhimeve të shtetit shqiptar ndaj dokumentit të partneritetit evropian. Gjithashtu, janë analizuar mangësitë dhe problemet kryesore që kanë ndikuar në mosrealizimin në afatet e përcaktuara të masave të parashikuara. Për realizimin e raportit është shfrytëzuar informacioni i marrë nga institucionet shtetërore në nivel nivel qendror dhe lokal, organizatat vendëse dhe të huaja që japin ndihmesën e tyre në këtë fushë, në intervista, si dhe në tryeza të rrumbullakëta me ekspertë vendës dhe ndërkombëtarë.

6. ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I ORGANIZATËS

6.1 Ngritje kapacitetesh të stafit të KSHH-së¹²

Komiteti Shqiptar i Helsinkit vazhdon t'i kushtojë rëndësi rritjes së kapaciteteve të stafit të ri. Në muajin dhjetor 2007, znj. Klejda Ngjela dhe znj. Valmira Kallushi morën pjesë në trajnimin “Menaxhimi i kohës”, organizuar nga qendra e trajnimeve “NET”. Qëllimi i trajnimit ishte dhënia e njohurive për një menaxhim sa më të mirë të kohës.

Në dhjetor 2007, tre anëtare të stafit të KShH-së: znj. Klesta Alikaj, znj. Etilda Saliu dhe znj. Ersida Sefa morën pjesë në trajnimin “Vendime kompetente, veprime me përgjegjësi”, organizuar nga qendra e trajnimeve “NET”.

6.2 Rritja e kapaciteteve të korrespondentëve të KSHH-së¹³

Më 19 tetor 2007, në kuadër të projektit të klinikës ligjore, mbështetur nga Komiteti Suedez i Helsinkit, KShH-ja organizoi një trajnim të korrespondentëve të vet për metodologjinë dhe disa aspekte ligjore. Në këtë trajnim u trajtuan aspekte të punës së klinikës ligjore, të veprimtarisë së saj, aspekte të metodologjisë së vëzhgimit në institucione të veçanta, metodologjia e marrjes së ankesës dhe e trajtimit të saj, si dhe metodologjia për rritjen e aksesit të qytetarëve të KShH-ja. U trajtuan, gjithashtu, aspekte ligjore të neneve më të rëndësishme të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe aspekte organizative të veprimtarisë së korrespondentëve në rrethet e tyre.

¹² Trajnimet e stafit të KShH-së realizohen në kuadër të projektit “Vëzhgimi i të drejtave të njeriut dhe forcimi institucional i organizatës”

¹³ Aktivitetet janë realizuar në kuadër të projektit “Për një mbrojtje më të mirë të viktimave të të drejtave të njeriut” – Klinika ligjore, mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit

Në datat 18-19 dhjetor 2007, korrespondenti i KShH-së në Elbasan, z. Ymer Leksi, mori pjesë në trajnimin e organizuar nga OSBE-ja: “Komentimi i projektlegjislationit”.

7. RITJA E BASHKËPUNIMIT TË KSHH-SË ME OJF-TË LOKALE DHE RAJONALE

7.1 Rritja e aksesit të OJF-ve lokale te KSHH-ja¹⁴

Gjatë muajit nëntor, korrespondenti i KShH-së në Elbasan ka marrë pjesë në aktivitetin e organizuar nga punonjësit socialë pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan. Në këtë aktivitet korrespondenti ka bërë një prezantim të veprimtarisë së KShH-së në përgjithësi dhe programit të klinikës ligjore në veçanti. Ai ka prezantuar objektivat dhe shërbimet që ofron KShH-ja nëpërmjet kësaj klinike ligjore.

7.2 Rritja e bashkëpunimit të KSHH-së me OJF-të lokale¹⁵

Gjatë muajit nëntor janë marrë takime me përfaqësues të ndryshëm të OJF-ve në nivel lokal nga korrespondentët e Elbasanit dhe të Korçës. Takimet janë marrë me përfaqësues të forumit të gruas në qytetin e Elbasanit, OJF-të lokale në Korçë, gazetarë dhe përfaqësues të OJF-ve në Gjirokastrë. Gjatë takimeve janë bërë prezantime të objektivave strategjike të KShH-së dhe të programit të klinikës ligjore si dhe është biseduar për një bashkëpunim më të frytshëm në të ardhmen.

7.3 Forcimi i bashkëpunimit rajonal për të drejtat e minoriteteve

Në datat 23-25 nëntor 2007, Friedrich Ebert Stiftung me qendër në Shkup, organizoi një takim me temën “Pjesëmarrja e minoriteteve dhe zbatimi i të drejtave të tyre”. Në këtë takim pjesëmarrësit prezantuan punimet e përgatitura. Për Komitetin Shqiptar të Helsinkit, punimin e përgatitur në lidhje me temën e prezantoi dr. Gjergji Sinani, ekspert pranë këtij Komiteti. Në takim morën pjesë përfaqësues dhe ekspertë të shoqatave që punojnë në fushën e të drejtave të minoriteteve në rajonin Ballkanik.

Përveç prezantimit të punimeve të përgatitura nga shoqatat pjesëmarrëse, në takim u vendosën përparësitë mbi bazën e të cilave do të vazhdojë bashkëpunimi edhe gjatë vitit 2008.

¹⁴ Aktivitetet janë realizuar në kuadër të projektit “Për një mbrojtje më të mirë të viktimave të të drejtave të njeriut” – Klinika ligjore, mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit

¹⁵ Aktivitetet janë realizuar në kuadër të projektit “Për një mbrojtje më të mirë të viktimave të të drejtave të njeriut” – Klinika ligjore, mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit

8. RITJA E AKSESIT TË QYTETARËVE TE KSHH-JA¹⁶

8.1 NËPËRMJET MATERIALEVE SENSIBILIZUESE

Për të rritur aksesin e publikut te shërbimet e ofruara nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2007 u botua një fletëpalosje si dhe kalendarë xhepi 2008. NËpërmjet këtyre mjeteve informative KShH-ja ka bërë të njohur te qytetarët ndihmën ligjore që ai ofron nëpërmjet klinikës ligjore.

Materialet informuese janë shpërndarë në Tiranë, Korçë, Fier, Elbasan, Shkodër, Gjirokastrë dhe rrethe të tjera nëpërmjet korrespondentëve, vëzhguesve të KShH-së dhe vetë stafit. Materialet sensibilizuese janë shpërndarë në mjedise publike, në mjediset e gjykatës, të Prokurorisë, të universiteteve dhe shkollave, të gjendjes civile, në mjediset e komisaritit të policisë, pranë pikave të shpërndarjes së gazetave, te disa OJF, te komuniteti rom dhe ai egjiptian etj.

8.2 Media elektronike dhe e ajo shkruar- mjet i dobishëm për rritjen e aksesit të publikut te KSHH-ja

Për rritjen e aksesit të KShH-së te publiku në përgjithësi dhe te viktimat e shkeljes së të drejtave të njeriut në veçanti, gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2007 u publikuan shërbimet që ofron klinika ligjore. Gjatë muajit nëntor 2007, nëpërmjet njoftimeve të shkurtra në televizionin News 24, si edhe te disa nga televizionet lokale në të cilat punojnë korrespondentët e KShH-së, si TV Korça dhe Televizionin Publik Gjirokastra, KShH-ja bëri publik e shërbimet që ofron klinika ligjore, si ndihmën ligjore falas, target grupin etj.

Korrespondentët e KShH-së kanë luajtur rol aktiv me intervistat e dhëna në median lokale të tyre për një prezantim të shkurtër të objektivave dhe shërbimeve të ofruara, për aktivitetet e KShH-së në rrethin përkatës etj. Intervista të tilla ka dhënë korrespondentja e Gjirokastrës në televizionet lokale, si TVGJ, TV ALPO, TV Channel⁷.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe KShH-ja ka zhvilluar disa emisione në TV dhe radiot lokale për të sensibilizuar qytetarët për shërbimet që ofron klinika ligjore për të gjithë shtetasit që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat. Për këtë çështje, znj Kaliopi Bici, korrespondente e KShH-së në Gjirokastrë zhvilloi një emision në TV Gjirokastra, më 13 dhjetor 2007.

¹⁶ Aktivitetet janë realizuar në kuadër të projektit “Për një mbrojtje më të mirë të viktimave të të drejtave të njeriut” – Klinika ligjore, mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit

KShH-ja përfundoi me sukses procesin e përgatitjes dhe të miratimit të planit strategjik 2008-2010.

Në kuadër të rritjes së standardeve dhe të qëndrueshmërisë së organizatës, gjatë periudhës tetor- dhjetor 2007, stafi i KShH-së punoi dhe arriti të kurorëzojë me sukses përfundimin e procesit të hartimit të planit strategjik të KShH-së për periudhën 2008-2010. Ky projektdokument u diskutua dhe u miratua në mbledhjen e bordit dhe më pas të Asamblesë së Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

Së shpejti dokumenti i miratuar do të bëhet publik për të gjithë personat e interesuar.